



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

Nr 18 Prot/b

Gjirokastrë, më 29 / 08 / 2017

N J O F T I M

Pranimet në ciklin e dytë të studimeve "Master profesional" dhe "Master i shkencave"

1. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, për të gjitha kategoritë e kandidateve bëhen pranë sekretarive mesimore të njësive kryesore në Universitetin "Eqrem Çabej" nga data,

29 gusht deri në datën 20 Tetor 2017 .

2. Brenda datës 24 Tetor 2017, UGJ-ja shpall dhe afishon listat e aplikanteve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, si dhe në faqen e web-it të universitetit (www.uogj.edu.al), të ndarë sipas programeve të studimit përkatëse, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara.
3. Kandidatët kanë të drejtën e ankimit në UGJ, brenda tri ditëve kalendarike **25, 26, 27 tetor** nga dita e shpalljes së rezultateve.

4. Regjistrimi i kandidateve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet pranë sekretarive mësimore përkatëse të universitetit deri në datën **30 Tetor 2017**.
5. Universiteti shpall në vende të dukshme dhe publikon në faqen e saj web-it (www.uogj.edu.al), listën emerore të kandidateve të regjistruar brenda datës **1 Nëntor 2017**.
6. Kanë të drejtë të aplikojnë për programet e ciklit të dytë, kandidatët që:
 - a) kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë, i cili rezulton i licencuar dhe akredituar në momentin e diplomimit të studentit, ose
 - b) janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të akredituar. Në rast pranimi kandidati është i detyruar të kryejë njehësimin e diplomes pranë MAS-it brenda muajit dhjetor 2017.
7. Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Diplomë, ose fotokopje të saj të njehësuar me origjinalin, të ciklit të parë të studimeve të përfunduar në Republikën e Shqipërisë. Diplomën e ciklit të parë të studimeve të përfunduar jashtë vendit, të shoqëruar me fotokopje të diplomës të njehësuar me origjinalin, ose, në mungesë të saj, të një dokumenti tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është kryer njehësimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, që i lejon regjistrimin dhe vazhdimin e studimeve universitare në vendin përkatës.
 - b) Diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave ose fotokopje të tyre të njehësuar me origjinalin, e konfirmuar nga njësi përkatëse arsimore vendore (DAR/ZA). Kandidatët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara hyrjes në fuqi të vendimit nr. 876, date 3.11.2010 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 78, date 08.02.2006 të Këshillit të Ministrave "Per krijimin e Matures Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike", i ndryshuar, paraqesin Dëftesën e Pjekurisë (original ose në rast fotokopje të saj, të njehësuar me origjinalin, të konfirmuar nga njësi përkatëse arsimore vendore DAR/ZA). Në qoftë se kandidatët nuk posedojnë dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesin dublikate të dëftesës së pjekurisë, të lëshuar nga drejtorja e shkolles së mesme ku ka përfunduar shkollën dhe të konfirmuar nga njësi përkatëse

arsimore vendore (DAR/ZA), ose dokumentin e leshuar nga Arkivi i Shtetit së bashku me listen e notave;

- c) Formulari i aplikimit (plotësohet pranë sekretarisë mësimore);
- d) Fotokopja e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë);
- e) Dy fotografi personale.
- f) Mandat pagesa prej 2.500 leke

Për çdo informacion shtesë mund të vizitoni faqen zyrtare online të Universitetit

www.uogj.edu.al

ose telefononi në nr e kontaktit të Zv/reaktorit për procesin mësimor Prof.asoc Jani Dine

Cel / 0684030043

Prof.dr Bektash Mema

Rektor

